



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Nr. 586 Prot.

Gjirokastrë, më 11.04.2024

Miratoi

Prof. dr. Bektash MEMA

REKTOR



**Lënda:** Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me partneritetin INTERCON, Spanjë.

Në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Stafit, INTERCON, Spanjë, organizon aktivitete në institucionin IES Abastos, Valencia.

Bazuar në komunikimin me postë elektronike zyrtare me institucionin pritës, Universiteti i Gjirokastrës do të përfaqësohet nga **5 pozicione** që përfshijnë stafin akademik dhe Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor.

Nga data 20 deri më 24 maj 2024 do të zhvillohen aktivitete që lidhen me prezantimin e veprimtarisë së institucioneve respektive dhe rrjetëzimin e universiteteve.

Të interesuarit të dërgojnë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **19.04.2024:**

- vërtetim punësimi;
- letër interesi në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në anglisht;
- provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze minimalisht të nivelit B2;
- fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ-së dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet palës partnere, për përzgjedhjen përfundimtare të aplikantëve.

**Përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor**

**Irma Gjolleshi**